



NËNTËDITËSHI KUSHTUAR SHËN NËNË TEREZËS



Don.

(Orke. 10/12/79)

Une gjithmonë e lehtë në
 zemër popullit. Tëni 30 qptar
 shumë luti kotu. qe fregja
 e tij të vijnë në zemrat
 tona, në gjithë shtet.
 tona, në gjithë kotu.
 Shtet shumë për fukarat
 e mij - dhe për mua
 dhe motrat e mijat.
 Une lutem për juve
 W. Teresa Pofaxhin

*Mbi gjurmët e
Nënës së të varfërve*

Përgatiti: don Anton UKA

Dita e parë

Pas lutjes përfundimtare të Meshës vazhdohet me një këngë kishtare, ndërsa meshtari me ministrantat bien në gjuhë para altarit, ku do të jetë e vendosur edhe ikona e Nënë Terezës.

Kremtuesi: Ndihma jonë është në emër të Zotit!

Populli: I cili e krijoi qiellin dhe tokën.

Kremtuesi: O Zot dëgjoje lutjen time!

Populli: Dhe britma ime le të vijë te ti.

Hyrje e shkurtër nga ana e kremtuesit...

Lexuesi: Të meditojmë me Nënë Terezën!

A e njihni me të vërtetë Jezusin e gjallë, jo nga librat, por nga qëndrimi me të në zemrat tuaj? A jeni të bindur për dashurinë e Krishtit për ju dhe tuajën për Të? Kjo bindje është shkëmbi, mbi të cilin ndërtohet shenjtëria. Çfarë duhet të bëjmë për ta pasur këtë bindje? Duhet ta njohim Jezusin, ta duam dhe t'i shërbejmë. Njohja do t'ju bëjë të fortë porsì vdekja. Ne e njohim Jezusin përmes besimit: përmes fjalës së Tij në Shkrimin e shenjtë, duke e dëgjuar derisa flet përmes Kishës së tij dhe përmes një bashkimi intim në lutje. Kërkojeni Jezusin në Tabernakull! Fiksoni sytë tuaj mbi Të, që është drita! Vendosni zemrën tuaj afër zemrës së Tij hyjnore dhe kërkojeni hirin për ta njohur atë!

Moment heshtjeje

Vendosjen e qiriut pranë ikonës së Nënë Terezës e përcjell një shpjegim i shkurtër:

Qiriu i ndezur simbolizon Krishtin e ringjallur, i cili i dhuroi botës dritën e jetës së pasosur. Vazhdimësi e kësaj drite ishin dhe vazhdojnë të jenë shenjtërit dhe shenjtëreshat e Zotit. Ndërmjetësia e

Mos jeto kurrë pa jetë

Dita më e bukur? Sot.
Pengesja më e madhe? Frika.
Gjëja më e lehtë? Të gabosh.
Gabimi më i madh? Të heqësh dorë.
Rrënja e çdo të keqeje? Egoizmi.
Humbja më e madhe? Mungesa e kurajës.
Profesionistët më të mirë? Fëmijët.
Nevoja e parë? Komunikimi.
Lumturia më e madhe? Të jesh i dobishëm për të tjerët.
Misteri më i madh? Vdekja.
E meta më e keqe? Të qenit pa humor.
Personi më i rrezikshëm? Ai që gënjen.
Ndjenja më e shëmtuar? Mëria.
Dhurata më e bukur? Falja.
Ajo më e paçmuara? Familja.
Ndjenja më e kënaqshme? Paqja e brendshme.
Pritja më e mirë? Buzëqeshja.
Ilaçi më i mirë? Optimizmi.
Kënaqësia më e madhe? Detyra e kryer.
Forca më e madhe? Besimi.
Gjëja më e bukur në botë? Dashuria.

S'ka rëndësi

Njeriu është i paarsyeshëm, i palogjikshëm, egoist, s'ka rëndësi, duaje.
Nëse bënë mirë, do të thonë se bënë për qëllime egoiste, s'ka rëndësi, bëj mirë.
Po realizove objektivat e tua, do të gjesh miq të rremë dhe armiq të vërtetë
s'ka rëndësi, realizoji.
E mira që bënë do të harrohet nesër,
s'ka rëndësi, bëje të mirën.
Ndershmëria dhe sinqeriteti të bëjnë të lëndueshëm,
s'ka rëndësi, ji i sinqerte dhe i ndershëm.
Ajo që për vite ke ndërtuar mund në një çast të prishet,
s'ka rëndësi, ndërto.
Nëse ndihmon njerëzit, do të lodhesh,
s'ka rëndësi, ndihmoju.

Lutje të Nënë Terezës

Jeta

Jeta është mundësi, PRANOJE.
Jeta është bukuri, ADMIROJE!
Jeta është lumturi, SHIJOJE!
Jeta është ëndërr, REALIZOJE!
Jeta është sfidë, BALLAFAQOJE!
Jeta është detyrë, KRYEJE!
Jeta është lojë, LUAJE!
Jeta është e çmueshme, NDEROJE!
Jeta është pasuri, RUAJE!
Jeta është dashuri, PËRJETOJE!
Jeta është fshehtësi, ZBULOJE!
Jeta është premtim, PLOTËSOJE!
Jeta është pikëllim, TEJKALOJE!
Jeta është, himn, KËNDOJE!
Jeta është tragjedi, ZBUTE!
Jeta është aventurë, ZBËRTHEJE!
Jeta është kënaqësi, MERITOJE!
Jeta është jetë, MBROJE!

Gjej kohë për të menduar

Gjej kohë për të menduar – është burimi i fuqisë.
Gjej kohë për t'u lutur – është fuqia më e madhe e botës.
Gjej kohë për të qeshur – është muzika e shpirtit.
Gjej kohë për lojë – është fshehtësia e rinisë.
Gjej kohë për të dashur – është dhurata e Zotit.
Gjej kohë për t'u dhuruar – është ngadhënjimi i dashurisë.
Gjej kohë për të lexuar – është burimi i urtisë.
Gjej kohë për t'u shoqëruar – është rrugë e lumturisë.
Gjej kohë për të punuar – është çmimi i ardhmërisë.
Gjej kohë për të bërë mirë – është çelësi që të shpie në Qiell.

Shën Nënë Terezës bëftë që drita e Krishtit të arrijë në të gjithë ata njerëz dhe në të gjitha ato familje, ku është e pranishme errësira dhe mëkati!

Lutja kushtuar Shën Nënë Terezës - kremtuesi:

Shën Nënë Tereza e Kalkutës, ti i lejove dashurisë së etshme të Jezusit në kryq, që brenda teje të bëhet flakë e gjallë, që të bëhesh për të gjithë dritë e dashurisë së Tij. Më nxirr hirin nga zemra e Jezusit që edhe jeta ime të rrezatojë mirësi, dashuri dhe falje! Më mëso të lejoj që Jezusi të depërtojë brenda meje dhe ta marrë pushtetin mbi qenien time, në mënyrë kaq të plotë, sa që edhe jeta ime të rrezatojë nga drita dhe dashuria e tij për të tjerët! Amen.

Angazhimi personal – të gjithë së bashku me zë të lartë:

Meqenëse Jezusi banon në mua, e pranoj angazhimin, se do të mundohem ta kërkoj Atë në të gjitha situatat e jetës sime.

Lutja e litanive të Shën Nënë Terezës, fq. 20.

Meshtari ngritët në këmbë, i drejtuar nga populli, ndanë bekimin përfundimtar të Meshës.

Kremtuesi: Zoti qoftë me ju!

Populli: Dhe me shpirtin tënd.

Kremtuesi: Ju bekoftë Hyji i gjithëpushtetshëm: Ati, Biri dhe Shpirti Shenjt!

Populli: Amen.

Kënga përmbyllëse kushtuar Nënë Terezës, fq. 23.

Dita e dytë

Pas lutjes përfundimtare të Meshës vazhdohet me një këngë kishtare, ndërsa meshtari me ministrantat bien në gjuhë para altarit, ku do të jetë e vendosur edhe ikona e Nënë Terezës.

Kremtuesi: Ndihma jonë është në emër të Zotit!

Populli: I cili e krijoi qiellin dhe tokën.

Kremtuesi: O Zot dëgjoje lutjen time!

Populli: Dhe britma ime le të vijë te ti.

Hyrje e shkurtër nga ana e kremtuesit...

Lexuesi: Të meditojmë me Nënë Terezën!

Nëse dëshiroj ta di sa e dua Krishtin, nëse dëshiroj ta di a jam vërtet i/e dashuruar në Zotin, duhet shikuar si veproj në punën dhe misionin që Ai ma ka besuar dhe sa dashuri kam në këtë veprim. A sheh, thirrja jonë nuk është veprimi. Misioni ynë është t'i përkasim tërësisht Jezusit, me siguri të plotë se asgjë s'do t'na ndajë prej dashurisë së tij. S'ka rëndësi se çka punojmë apo sa punojmë, por sa dashurojmë dhe sa dashuri kemi në punën që na është besuar. Atë çka ti vepron, ndoshta unë s'mund ta punoj... Atë çka unë veproj, ndoshta ti s'mund ta punosh... Por, të gjithë së bashku bëjmë diçka të bukur për Zotin.

Moment heshtjeje

Vendosjen e kryqit pranë ikonës së Nënë Terezës e përcjell një shpjegim i shkurtër:

Kryqi është simboli i fitores; i ngadhënjimit të jetës mbi vdekjen, përmes të cilit Jezusi i solli botës shëlbimin. Në kundërshtim e takojmë lirinë tonë të keqpërdorur: krenarinë, mllëfën, përbuzjet, sharjet, padrejtësitë, gjykimet, krimet, vrasjet e pafajshme, sikurse ishte ajo e Jezusit në kryq. Por, në kryq, njëkohësisht, takojmë edhe

të "Loretos" dhe veshi sarin e bardhë, të përshkuar me vijë të kaltër dhe me kryq në parzëm. Pastaj shkoi rreth tre muaj në Patna, të Motrat Mjeke Misionare (Medical Missionary), për të kryer edhe një kurs intensiv për infermiere.

21 dhjetor 1948 - Merr lejen për hapjen e shkollës së parë, lokali i të cilës ishte një kasolle nga lagjet më të varfra të Kalkutës, Tilje dhe Motijil, bashkon fëmijët e lënë dhe të braktisur në atë shkollë, ndërsa vetë banonte te Motrat e Vogla të të Varfrit.

1952 - Hapi shtëpinë e parë pranë tempullit të hyjneshës Kali në Kalkutë. Përrurimi i saj u bë më 22 gusht, në festën e Zemrës së Papërlyer të Marisë. Këtë shtëpi e pagëzoi si Nirmal Hriday (Shtëpia e zemrës së pastër). Me këtë emër do t'i quajë edhe shumë shtëpi tjera në mbarë Indinë dhe më gjerë.

5 shtator 1997 - Nëna Tereze ndërroi jetë. Shpirti i saj e la trupin, i cili u harxhua për vëllain njeri dhe kaloi në përjetësinë e Zotit, kaloi në jetën e Zotit, e cila është jetë e pambarim. Me këtë rast u dhanë deklarata të shumta, u mbajtën ditë zie dhe pikëllimi. Lajmin për vdekjen e saj e dha në, pothuaj, të gjitha kanalet televizive botërore.

13 shtator 1997 - U varros Nëna Tereze me nderimet më të larta që organizoi Qeveria indiane. Në varrimin e saj morën pjesë shumë burra shtetesh.

19 tetor 2003 – Në Vatikan u bë lumturimi i Nënë Terezës, nga Papa Gjon Pali II.

4 shtator 2016 – Në Vatikan u bë shenjtërimi i Nënë Terezës, nga Papa Françesku.

Biografia kronologjike e Nënë Terezës

27 gusht 1910 - në Shkup u lind Gonxhe Bojaxhiu, bija e Kolë Bojaxhiut nga Prizreni dhe Drane I. Benajt, me prejardhje nga Novosella e Gjakovës.

27 gushti i vitit 1910 ia shtoi familjes Bojaxhiu fëmijën e tretë, pas dy të parëve, Agës dhe Lazrit. Në familjen Bojaxhiu Gonxhja thithi nektarin e parë të fesë së Krishtit dhe të gjakut të të parëve të vet. Që nga fëmijëria e hershme së bashku me familjen shtegtoi në shenjtëroren e Zojës Cernagore në Letnicë – Kosovë.

Fati i mirë i Nënës Tereze ishte edhe lindja e saj në një familje të shëndoshë apo siç thoshte vetë ajo: "Ishim të gjithë të bashkuar... jetonin njëri për tjetrin... Ishim familje e bashkuar dhe shumë e lumtur."

1919 - Në rrethana të dyshimta i vdes babai, Kolë Bojaxhiu, tregtar i zgjuar, veprimtar i zellshëm dhe besnik për pavarësinë dhe lirinë e Shqipërisë.

1915-1924 - Shkolla dhe jeta në famulli. Vijon me zell shkollimin dhe ishte e rregullt në veprimtarinë e jetës famullitare: në Meshë dhe katekizëm. Lazri, vëllai i saj, dëshmon: "Jetonim afër kishës famullitare të Zembrës së Krishtit. Nganjëherë nëna dhe motrat e mia, Ageja dhe Gonxhja, më bënin mbresa, se po rrinë sa në shtëpi aq në kishë. Sepse, kaq shumë ishin të preokupuara me korin e famullisë, me shërbimet fetare dhe temat për misione".

26 shtator 1928 - Thirrja rregulltare. Pikërisht më 26 shtator 1928 nisët për në Zagreb, në përcjelljen e nënës Drane dhe motrës Age, ku do të qëndrojë deri më 13 tetor. Në ditën e 13 tetorit, së bashku me zonjushën Betike Kanjić nisët për në Irlandë. Udhëtimi nga Zagrebi kaloi nëpër Austri, Zvicër, Francë dhe pastaj me anije nëpër kanalin e Lamanshit vazhduan rrugën drejt Londrës, prej kah u nisën për në Dublin. Në Dublin qëndruan rreth dy muaj të angazhuara në mësimin e gjuhës angleze.

18 gusht 1946 - Ndërroi veshjen. La veshjen rregulltare të motrave

lirinë e Zotit, i cili nga dashuria e madhe për njerëzimin, në durim dhe heshtje, pranon të shahet, të përbuzet dhe të vritet, duke u lutur për keqbërësit: "Fali, o Atë, se nuk dinë çka bëjnë!" Ndërmjetësia e Shën Nënë Terezës bëftë që edhe ne, në shembullin e Krishtit, të duam dhe të falim deri në vdekje! Amen.

Lutja kushtuar Shën Nënë Terezës - krentuesi:

Shën Nënë Tereza e Kalkutës, ti që për shumë vite jetove në natën e errët të shpirtit, pa e humbur besimin dhe pa e shuar dashurinë për Zotin dhe për njeriun. Ndihej, po të lutemi, që t'i pranojmë kryqet e jetës dhe tundimet që vijnë nga Djalli, nga mishi dhe gjaku, si dhe nga të tjerët, duke besuar se vetëm lidhja e ngushtë me Fjalën e Zotit, me uratën dhe me heshtjen kundruese të mistereve të Tua, do të na ndihmojë të ngadhënjëjmë mbi të këqijat që na sulmojnë! Amen.

Angazhimi personal – të gjithë së bashku me zë të lartë:

Meqenëse Jezusi më premtonte, se pranimi i kryqeve të përditshme të jetës nënkupton shëlbimin, premtoj se do të angazhohem t'i pranojë ato me dashuri dhe besim.

Lutja e litanive të Shën Nënë Terezës, fq. 20.

Meshtari ngritët në këmbë, i drejtuar nga populli, ndanë bekimin përfundimtar të Meshës.

Krentuesi: Zoti qoftë me ju!

Populli: Dhe me shpirtin tënd.

Krentuesi: Ju bekoftë Hyji i gjithëpushtetshëm: Ati, Biri dhe Shpirti Shenjt!

Populli: Amen.

Kënga përmbyllëse kushtuar Nënë Terezës, fq. 23.

Dita e tretë

Pas lutjes përfundimtare të Meshës vazhdohet me një këngë kishtare, ndërsa meshtari me ministrantat bien në gjunjë para altarit, ku do të jetë e vendosur edhe ikona e Nënë Terezës.

Kremtuesi: Ndihma jonë është në emër të Zotit!

Populli: I cili e krijoi qiellin dhe tokën.

Kremtuesi: O Zot dëgjoje lutjen time!

Populli: Dhe britma ime le të vijë te ti.

Hyrje e shkurtër nga ana e kremtuesit...

Lexuesi: Të meditojmë me Nënë Terezën!

Krishti na mëson ta duam Zotin me gjithë zemër dhe të afërmin tonë porsì vetveten. Ky është urdhër i Zotit. Ai na urdhëron këtë gjë, e kjo nuk është diçka e pamundshme. Dashuria është pemë e pjekur për të gjitha kohërat, afër dorës së gjithkujt. Secili mund ta marr pa dallim, secili mund ta mbërrijë këtë dashuri: duke kundruar, duke lutur dhe duke u flijuar. Nëse e zbulojmë Zotin nëpër dashurinë e drejtpërdrejtë të Tij, vepër kjo në brendinë tonë, ndihemi të përshkuar nga dëshira për të qenë të gëzuar, për të dashur. Por, jo për të dashur me fjalë, dashuria ka vepra, dashuria sjell gëzim, dashuria na bashkon me Zotin. Amen.

Moment heshtjeje

Vendosjen e Biblës pranë ikonës së Nënë Terezës e përcjell një shpjegim i shkurtër:

Bibla është libri i shenjtë i të krishterëve, në të cilin janë të përmbledhura dhe të fshehura urtit, dituritë dhe të gjitha misteret hyjnore dhe njerëzore. Kryefjala e Biblës është Krishti, Fjalë e mishëruar dhe e bërë njeri. Nga kjo Fjalë, Nënë Tereza e dëgjoj thirrjen: “Kam etje!”, thirrje kjo që u bë program jete për të, për

O Qengji i Zotit, që shlyen mëkatet e botës!

Falna ne, o Zot

O Qengji i Zotit, që shlyen mëkatet e botës!

Dëgjona ne, o Zot!

O Qengji i Zotit, që shlyen mëkatet e botës!

Ki mëshirë për ne!

Të lutemi: O Zot, i Gjithëpushtetshëm dhe i amshuar, bëjë që, përmes ndërmjetësisë të Shën Nënë Terezës së Kalkutës, e cila të shërbeu në më të varfrit ndër të varfër dhe të nderoi thellësisht në praninë eukaristike, të fitojmë edhe ne forcë dhe zell për t’i ndihmuar të varfrit e çdo kategorie dhe për t’u bërë gjithmonë krah i qëndrueshëm i të nëpërkëmburve dhe i të përbuzurve, e kështu të takojmë dhe të duam Ty në vëllain njeri! Amen.

Kënga përmbyllëse, kushtuar Nënë Terezës

Me ato duar të arta,
Shërbeve v'llait njeri.
Me atë zemër të pastër,
Ti mbjelle dashuri.

Ref. Ato duar ishin të shenjta.
Ajo zemër plot dashuri.
Ata sy në çdo të varfër,
Takuan Krishtin fëmijë.

Fjala e jote e ëmbël,
Shikimi yt plot mëshirë.
Me një buzëqeshje si dielli,
Ti shndrite në errësirë.

Ref. Lutu, o Nëna jonë Tereze
Lutu për popullin shqiptar
Që më zemër t’i përket Zotit,
Të kthehet çdo m’katar
Të kthehet bota mbarë

Shën Nënë Tereza, kushtrimi i barazisë shoqërore!
 Lutu për ne!
Shën Nënë Tereza, nëna e të gjithë të gërbulurve!
 Lutu për ne!
Shën Nënë Tereza, zamare e himneve të Orëve!
 Lutu për ne!
Shën Nënë Tereza, perla e virgjërisë!
 Lutu për ne!
Shën Nënë Tereza, kasnece e Lajmit të gëzueshëm!
 Lutu për ne!
Shën Nënë Tereza, adhuresë e meshtarisë!
 Lutu për ne!
Shën Nënë Tereza, shërbëtore e të gjithëve!
 Lutu për ne!
Shën Nënë Tereza, zemra e artë e Kishës!
 Lutu për ne!
Shën Nënë Tereza, testamenti i dashurisë ndaj të varfërve!
 Lutu për ne!
Shën Nënë Tereza, zbuluese e Zotit!
 Lutu për ne!
Shën Nënë Tereza, vravashkë e pashuar!
 Lutu për ne!
Shën Nënë Tereza, forcimi i besimit tonë në Zotin!
 Lutu për ne!
Shën Nënë Tereza, mishërimi i virtyteve hyjnore!
 Lutu për ne!
Shën Nënë Tereza, shtëpi e lutjes dhe e përkormërisë!
 Lutu për ne!
Shën Nënë Tereza, shëmbëlltyrë dhe nxitje nga jeta e virtyteve!
 Lutu për ne!
Shën Nënë Tereza, dritare e Qiellit!
 Lutu për ne!
O Krisht, ndjena ne!
 O Krisht, ndjena ne!
O Krisht, dëgjona ne!
 O Krisht, dëgjona ne!

Motrat e saja dhe për Vëllezërit e saj misionarë. Ndërmjetësia e Shën Nënë Terezës bëftë, që rinia jonë, nga takimi me Fjalën e Zotit, të zbulojë dhe të pranojë thirrjen për të jetuar sipas vullnetit të Atit tonë qiellorë!

Lutja kushtuar Shën Nënë Terezës - krentuesi:

Shën Nënë Tereza e Kalkutës, ti që i lejove Fjalës së amshuar të depërtojë në mendjen dhe në zemrën tënde, ndihmona po të lutemi, që të mos jemi të shurdhër përballë fjalëve tua, që na paraqiten në momente dhe situata të ndryshme të jetës! Na nxirr hirin nga zemra e Jezusit, që përballë situatave të vështira të njerëzve në nevojë, mos të kalojmë përtej indiferent si prifti dhe mësuesi i ligjit, por në shembullin e Samaritanit të mirë, të ndalemi, të shikojmë, të ndihmojmë, të lehtësojmë dhe të shërojmë plagët e njerëzve që edhe sot e kësaj dite lëngojnë në trup dhe në shpirt! Amen.

Angazhimi personal – të gjithë së bashku me zë të lartë:

Meqenëse Jezusi është i pranishëm në jetën e secilit njeri, e pranoj angazhimin se do të mundohem të ndalem për t'i ndihmuar njerëzit që kanë nevojë për ndihmën time.

Lutja e litanive të Shën Nënë Terezës, fq. 20.

Meshtari ngritët në këmbë, i drejtuar nga populli, ndanë bekimin përfundimtar të Meshës.

Krentuesi: Zoti qoftë me ju!

Populli: Dhe me shpirtin tënd.

Krentuesi: Ju bekoftë Hyji i gjithëpushtetshëm: Ati, Biri dhe Shpirti Shenjt!

Populli: Amen.

Kënga përmbyllëse kushtuar Nënë Terezës, fq. 23.

Dita e katërt

Pas lutjes përfundimtare të Meshës vazhdohet me një këngë kishtare, ndërsa meshtari me ministrantat bien në gjunjë para altarit, ku do të jetë e vendosur edhe ikona e Nënë Terezës.

Kremtuesi: Ndihma jonë është në emër të Zotit!

Populli: I cili e krijoi qiellin dhe tokën.

Kremtuesi: O Zot dëgjoje lutjen time!

Populli: Dhe britma ime le të vijë te ti.

Hyrje e shkurtër nga ana e kremtuesit...

Lexuesi: Të meditojmë me Nënë Terezën!

O Atë i qiellit, që na dhe një shëmbëllesë të jetës në familjen e Nazaretit. Na ndihmo, o Atë i dashurisë, t'i bëjmë familjet tona një Nazaret të dytë, ku mbretërojnë dashuria, paqja dhe gëzimi! Bëjë të kemi një familje të lutjes, të dhënë pas Eukaristisë dhe jetës gjallëruese! Na ndihmo të jemi së bashku në gëzime, së bashku në dhimbje, së bashku në huret e lutjes familjare! Na mëso ta shohim në anëtarët e familjes sonë, Krishtin, atë të vuajturin! Na ndihmo që të kthehet në zemrat tona përvujtëria, siç ishte ajo e zemrës së Jezusit! Na ndihmo t'i kryejmë detyrat tona familjare! Na ndihmo, o Atë i dashurisë, të kryejmë çdo gjë me buzëqeshje! O zemër e dëlirë e Marisë, shkak i gëzimit tonë, lutu për ne! Shën Jozefi, lutu për ne! Shenjtërit Engjëjt e Rojës, jini gjithnjë me ne, duke na mbrojtur e duke na dalë zot! Amen.

Moment heshtjeje

Vendosjen e rruzares pranë ikonës së Nënë Terezës e përcjell një shpjegim i shkurtër:

Kurora e rruzares, simbolizon bashkimin tonë në lutje me Virgjëren Mari dhe Jezusin. Sa herë që lutemi dhe bashkohemi në emër të

Shën Nënë Tereza, themeluese e Misionareve të Dashurisë!
Lutu për ne!

Shën Nënë Tereza, shembull i fesë së gjallë!
Lutu për ne!

Shën Nënë Tereza, shembull i durimit!
Lutu për ne!

Shën Nënë Tereza, ngadhënjyese mbi pritrat e Djallit!
Lutu për ne!

Shën Nënë Tereza, shëmbëlltyrë e përvujtërisë!
Lutu për ne!

Shën Nënë Tereza, e dashura e të gjithë të varfërve!
Lutu për ne!

Shën Nënë Tereza, zotëruese e kohës!
Lutu për ne!

Shën Nënë Tereza, rrënuese e lodhjes!
Lutu për ne!

Shën Nënë Tereza, përkrahësja e pushimit për lutje!
Lutu për ne!

Shën Nënë Tereza, mishërimi i dashurisë së Jezusit ndaj të varfërve!
Lutu për ne!

Shën Nënë Tereza, lapsi i Zotit!
Lutu për ne!

Shën Nënë Tereza, e fejuara e Krishtit!
Lutu për ne!

Shën Nënë Tereza, lypsare e nevojtarëve!
Lutu për ne!

Shën Nënë Tereza, ofshama e skamnorëve!
Lutu për ne!

Shën Nënë Tereza, streha e të braktisurve prej të gjithëve!
Lutu për ne!

Shën Nënë Tereza, klithja e fëmijëve të pa lindur!
Lutu për ne!

Shën Nënë Tereza, ndërgjegjësimi i atyre që nuk besojnë!
Lutu për ne!

Shën Nënë Tereza, shpresa e zemërthyerve!
Lutu për ne!

Litanitë e Shën Nënë Terezës

O Zot, ki mëshirë!

O Zot, ki mëshirë!

O Krisht, ki mëshirë!

O Krisht, ki mëshirë!

O Zot, ki mëshirë!

O Zot, ki mëshirë!

O Krisht, ndjena ne!

O Krisht, ndjena ne!

O Krisht, dëgjona ne!

O Krisht, dëgjona ne!

Ati prej qiellit Zot!

Ki mëshirë për ne!

Biri Shëlbues i botës Zot!

Ki mëshirë për ne!

Shpirti Shenjt Zot!

Ki mëshirë për ne!

Trinia e shenjtë, një i vetmi Zot!

Ki mëshirë për ne!

Shën Nënë Tereza, Misionare e dashurisë!

Lutu për ne!

Shën Nënë Tereza, zelltare e misionëve!

Lutu për ne!

Shën Nënë Tereza, vatër e miqësisë!

Lutu për ne!

Shën Nënë Tereza, vegimtare e përjetësisë!

Lutu për ne!

Shën Nënë Tereza, vizionare e paqes!

Lutu për ne!

Shën Nënë Tereza, çrrënjësja e racizmit!

Lutu për ne!

Shën Nënë Tereza, mistike e Eukaristisë!

Lutu për ne!

Shën Nënë Tereza, rregulltare e guximshme!

Lutu për ne!

Jezusit, edhe ne do t'i dhurojmë vetvetes dhe botës, mirësi, shpresë dhe dashuri. Ndërmjetësia e Shën Nënë Terezës bëftë që urata të jetë e pranishme për çdo ditë, në të gjitha familjet tona dhe kështu të mbizotërojë paqja, gëzimi, falja dhe dashuria!

Lutja kushtuar Shën Nënë Terezës - krentuesi:

Shën Nënë Tereza e Kalkutës, ti që kurorën e rruzares e vendose në petkun e kushtimit tënd, në mënyrë që ajo të shoqërojë në të gjitha lëvizjet tua: na ndihmo po të lutemi, që edhe ne ta kuptojmë vlerën e lutjes së rruzares dhe ta rikthejmë atë në familjet tona! Ndhimona po të lutemi që të besojmë se familjet që luten bashkërisht, do të jenë të lumtura dhe do të jetojnë të bashkuara! Amen.

Angazhimi personal – të gjithë së bashku me zë të lartë:

Ngaqë lutja e rruzares më bashkon me familjen e shenjtë të Nazaretit dhe më premtion hire dhe bekime të shumta: e pranoj angazhimin se do të mundohem që ta lus atë për çdo ditë në familjen time.

Lutja e litanive të Shën Nënë Terezës, fq. 20.

Meshtari ngritët në këmbë, i drejtuar nga populli, ndanë bekimin përfundimtar të Meshës.

Krentuesi: Zoti qoftë me ju!

Populli: Dhe me shpirtin tënd.

Krentuesi: Ju bekoftë Hyji i gjithëpushtetshëm: Ati, Biri dhe Shpirti Shenjt!

Populli: Amen.

Kënga përmbyllëse kushtuar Nënë Terezës, fq. 23.

Dita e pestë

Pas lutjes përfundimtare të Meshës vazhdohet me një këngë kishtare, ndërsa meshtari me ministrantat bien në gjuhë para altarit, ku do të jetë e vendosur edhe ikona e Nënë Terezës.

Kremtuesi: Ndhima jonë është në emër të Zotit!

Populli: I cili e krijoi qiellin dhe tokën.

Kremtuesi: O Zot dëgjoje lutjen time!

Populli: Dhe britma ime le të vijë te ti.

Hyrje e shkurtër nga ana e kremtuesit...

Lexuesi: Të meditojmë me Nënë Terezën!

Sa shumë kemi nevojë për Zojën e bekuar, që të na mësojë çfarë do të thotë të shuash dashurinë, e cila ka etje për ne, që Jezusi erdhi të na shfaqë! Ajo këtë gjë e bëri për bukuri. Po, Maria e lejoi Zotin, që jetën e saj ta zotërojë plotësisht përmes pastërtisë, përvujtërisë dhe dashurisë së saj besnike. Të përpiqemi nën udhëheqjen e Nënës sonë qiellore, që në ne, në shpirt, të rriten këto tri sjellje të brendshme, që i japin gëzim zemrës së Zotit, duke e lejuar që të bashkohet me ne, në Krishtin dhe përmes Krishtit, në fuqinë e Shpirtit Shenjt! Duke i përngjarë Marisë, nënës sonë, do t'i lejojmë Zotit, që të marrë pushtetin e plotë mbi qenien tonë. Në këtë mënyrë, Zoti me dashurinë e Tij të etshme, përmes nesh mund të arrijë të gjithë ata, me të cilët takohemi. Amen.

Moment heshtjeje

Vendosjen e figurës së Virgjërës Mari pranë ikonës së Nënë Terezës e përcjell një shpjegim i shkurtër:

Zoja e bekuar, në përschpirtërinë e Nënë Terezës ishte simboli i bukurisë, i dëlirësisë, i dashurisë, i përvujtërisë dhe i pastërtisë mendore, trupore dhe shpirtërore. Ndërmjetësia e Shën Nënë

shpirtërore. Sa herë që më mëkatet tona e mohojmë Zotin dhe të afërmin, e shporojmë kraharorin e Krishtit, nga i cili rrjedh gjak dhe ujë, jo për ta dënuar botën, por për ta pastruar dhe vetëdijësuar atë, se çdo pendim dhe kthim në vepra dashurie është shërim i plagëve dhe ndërprerje e rrjedhjes së gjakut të pafajshëm. Ndërmjetësia e Shën Nënë Terezës bëftë që Gjaku i pafajshëm i Krishtit të na pastrojë dhe t'i shërojë plagët e trupit dhe të shpirtit tonë!

Lutja kushtuar Shën Nënë Terezës - kremtuesi:

Shën Nënë Tereza e Kalkutës, ti që me dashuri e pranove mësimin e Virgjërës Mari: “Bëni gjithçka t’ju thotë Krishti”, ndihmona që edhe ne të jemi nxënës besnik të fjalëve të Krishtit! Na nxirr hirin nga zemra e Jezusi, që me përvujtëri dhe falënderim t’i pranojmë sakramentet e shenjta, shenja të dashurisë dhe të mëshirës hyjnore!

Angazhimi personal – të gjithë së bashku me zë të lartë:

Meqë besoj se në Kungimin shenjt është Krishti realisht i pranishëm: e pranoj angazhimin, se do të mundohem ta pranojë atë me zemër dhe mendje sa më të pastër.

Lutja e litanive të Shën Nënë Terezës, fq. 20.

Meshtari ngritët në këmbë, i drejtuar nga populli, ndanë bekimin përfundimtar të Meshës.

Kremtuesi: Zoti qoftë me ju!

Populli: Dhe me shpirtin tënd.

Kremtuesi: Ju bekoftë Hyji i gjithëpushtetshëm: Ati, Biri dhe Shpirti Shenjt!

Populli: Amen.

Kënga përmbyllëse kushtuar Nënë Terezës, fq. 23.

Dita e nëntë

Pas lutjes përfundimtare të Meshës vazhdohet me një këngë kishtare, ndërsa meshtari me ministrantat bien në gjunjë para altarit, ku do të jetë e vendosur edhe ikona e Nënë Terezës.

Kremtuesi: Ndhima jonë është në emër të Zotit!

Populli: I cili e krijoi qiellin dhe tokën.

Kremtuesi: O Zot dëgjoje lutjen time!

Populli: Dhe britma ime le të vijë te ti.

Hyrje e shkurtër nga ana e kremtuesit...

Lexuesi: Të meditojmë me Nënë Terezën!

Sot, bota ka shumë të këqija. Si t'i mposhtim ato? A thua t'i rrokim armët dhe bombat? Të bëjmë kryengritje dhe demonstrata? A thua duhet të mallkojmë dhe të urrejmë? Jo. Duhet të kapemi për dashuri dhe mëshirë. Paqja fillon me buzëqeshje. Buzëqeshja u takon të gjithë njerëzve. Buzëqeshja e aftëson njeriun për paqe. Vuajtja dhe hidhërimi s'kanë kuptim në vete. Por, vuajtja është pjesëmarrje në mundimet e Krishtit. Ajo është një dhuratë e shenjtë e dashurisë së Zotit, sepse në këtë mënyrë na bëhet me dije se sa e do Krijuesi botën – ku e dha Birin e vet për t'u flijuar për ne. Vuajtja e Krishtit pati kuptim. Ajo u shkri në gëzimin e të ngjallurit të Tij. Mendo, nëse e ndien në zemër vuajtjen e Krishtit, se si do të vijë pandalshëm të ngjallurit, do të afrohet gëzimi i Pashkëve.

Moment heshtjeje

Vendosjen e rrushit pranë ikonës së Nënë Terzës e përcjell një shpjegim i shkurtër:

Rrushi që po paraqesim para ikonës së Nënë Terezës, simbolizon verën, që në momentin e Meshës shenjte, nga duart e meshtarit, shndërrohet në gjakun e Krishtit dhe i dhurohet botës si pije

Terezës bëftë që virtytet e Virgjërës Mari, të jenë edhe sot e kësaj dite, nxitje dhe frymëzim për jetën e të krishterëve, sidomos të atyre që, për arsye të epsheve dhe dëshirave të ndyta, i kanë lejuar vetit, ta njollosoin tempullin e shenjtë të trupit, të mendjes, të zemrës dhe të shpirtit të tyre!

Lutja kushtuar Shën Nënë Terezës - kremtuesi:

Shën Nënë Tereza e Kalkutës, ti që me sakrificë dhe përkushtim të madh e ruajte pastërtinë e mendjes, zemrës, trupit dhe të shpirtit tënd, ndihmona, po të lutemi, që të kuptojmë dhe të besojmë se trupi ynë është Tempulli dhe Tabernakulli, në të cilin banon i Madhi Zoti! Ndhimona të kemi respekt për trupin tonë dhe atë të të tjerëve; ndihmona që mos ta shohim njeriun si një mjet që duhet përdorur dhe shfrytëzuar; ndihmona që të lirohemi nga ato mendime dhe veprime që na robërojnë dhe na bëjnë skllevër të veseve; ndihmona që, në shembullin e Virgjërës Mari, ta ruajmë pastërtinë e mendjes dhe të zemrës! Amen.

Angazhimi personal – të gjithë së bashku me zë të lartë:

I vetëdijshëm se edhe unë jam një Tempull i Zotit: e pranoj angazhimin se do të mundohem ta ruaj të pastër shpirtin tim.

Lutja e litanive të Shën Nënë Terezës, fq. 20.

Meshtari ngritët në këmbë, i drejtuar nga populli, ndanë bekimin përfundimtar të Meshës.

Kremtuesi: Zoti qoftë me ju!

Populli: Dhe me shpirtin tënd.

Kremtuesi: Ju bekoftë Hyji i gjithëpushtetshëm: Ati, Biri dhe Shpirti Shenjt!

Populli: Amen.

Kënga përmbyllëse kushtuar Nënë Terezës, fq. 23.

Dita e gjashtë

Pas lutjes përfundimtare të Meshës vazhdohet me një këngë kishtare, ndërsa meshtari me ministrantat bien në gjuhë para altarit, ku do të jetë e vendosur edhe ikona e Nënë Terezës.

Kremtuesi: Ndihma jonë është në emër të Zotit!

Populli: I cili e krijoi qiellin dhe tokën.

Kremtuesi: O Zot dëgjoje lutjen time!

Populli: Dhe britma ime le të vijë te ti.

Hyrje e shkurtër nga ana e kremtuesit...

Lexuesi: Të meditojmë me Nënë Terezën!

Bashkësia ime janë të varfrit. Siguria e tyre është e imja. Shëndeti i tyre është i imi. Shtëpia e tyre është e imja. Fëmijëve dhe të varfërve, të gjithë atyre që vuajnë, jepjani, jo vetëm kujdesin tuaj, por edhe zemrën tuaj. Sepse jeta e atyre që askush nuk i afrohet, për arsye se janë të infektuar, plot mikrobe dhe qelbësirë; e atyre që nuk shkojnë në lutje, sepse s'mund të dalin nga shtëpia të zdeshur; e atyre që nuk mund të hanë, sepse s'kanë fuqi; e atyre që rrinë nëpër trotuare, duke e ditur se po vdesin dhe që përkaj tyre kalojnë njerëzit dhe as nuk i shikon... është e imja. Shtëpia e tyre është e imja. Bota e tyre është e imja. Në zemrën time ka vend për ta, por edhe për shumë të tjerë, për të gjithë. Mëkati më i madh është: mungesa e dashurisë, moskujdesi për të afërmin.

Moment heshtjeje

Vendosjen e një fotografie me të varfër pranë ikonës së Nënë Terezës e përcjell një shpjegim i shkurtër:

Të varfrit për Nënë Terezën ishin vetë Jezusi, që përmes tyre thoshte: Kam etje për dashuri, për butësi, për mirëkuptim, për ndihmë, për pranim, për falje. Ndërmjetësia e Shën Nënë Terezës bëftë, që fjalët e Krishtit: “Sa herë që i keni ndihmuar një të varfëri,

mungojë kurrë në familjet tona, sidomos të mos mungojë në ato vende dhe zemra të varfra!

Lutja kushtuar Shën Nënë Terezës - kremtuesi:

Shën Nënë Tereza e Kalkutës, ti që më jetën tënde na dëshmove, se Krishti është buka e jetës, ndihmona që edhe ne të kuptojmë dhe t'ua dëshmojmë të tjerëve, se Jezusi është Fjala që duhet shpallur me gëzim! Ndihma, që në shembullin tënd, të dëshmojmë se Jezusi është e vërteta që duhet treguar, rruga që duhet ndjekur, dashuria që duhet dashuruar, gëzimi që duhet ndarë, paqja që duhet dhënë, buka që duhet ngrënë, uria që duhet ushqyer, etja që duhet shuar, i sëmuri që duhet shëruar, i vetmuari që duhet ngushëlluar! Na nxirr hirin nga zemra e Jezusi, që të dimë të vdesim, si fara e mbjellë në dhe, e kështu të japim shumë fryte!

Angazhimi personal – të gjithë së bashku me zë të lartë:

Meqenëse Krishti më premtun se ekziston më shumë gëzim në dhurim, sesa në pranim: e pranoj angazhimin, se do të mundohem ta luftojë egoizmin që fshihet në jetën time.

Lutja e litanive të Shën Nënë Terezës, fq. 20.

Meshtari ngritët në këmbë, i drejtuar nga populli, ndanë bekimin përfundimtar të Meshës.

Kremtuesi: Zoti qoftë me ju!

Populli: Dhe me shpirtin tënd.

Kremtuesi: Ju bekoftë Hyji i gjithëpushtetshëm: Ati, Biri dhe Shpirti Shenjt!

Populli: Amen.

Kënga përmbyllëse kushtuar Nënë Terezës, fq. 23.

Dita e tetë

Pas lutjes përfundimtare të Meshës vazhdohet me një këngë kishtare, ndërsa meshtari me ministrantat bien në gjunjë para altarit, ku do të jetë e vendosur edhe ikona e Nënë Terezës.

Kremtuesi: Ndihma jonë është në emër të Zotit!

Populli: I cili e krijoi qiellin dhe tokën.

Kremtuesi: O Zot dëgjoje lutjen time!

Populli: Dhe britma ime le të vijë te ti.

Hyrje e shkurtër nga ana e kremtuesit...

Lexuesi: Të meditojmë me Nënë Terezën!

Sot Zoti e do botën nëpërmjet nesh... Ai na ka dashur ashtu, sa që në kryq ka vdekur për ne. Aq shumë na ka dashur, sa që për çdo ditë bëhet Buka e Jetës. Edhe ne lypset ta duam, edhe ne duhet të dhurohemi deri në dhembje... Sepse Zoti e do botën nëpërmjet nesh. Ai vazhdon ta dashurojë botën, duke na dërguar ne në botë, që të jemi Dashuria e Tij, drita e Tij, ngushëllimi i Tij.

Moment heshtjeje

Vendosjen e grurit pranë ikonës së Nënë Terezës e përcjell një shpjegim i shkurtër:

Gruri që po e vendosim para ikonës së Nënë Terezës, është dhuratë e Zotit dhe fryt i punës së duarve të njeriut. Nga gruri kemi bukën materiale dhe atë shpirtërore. Buka na bashkon vëllazërisht në familje. Buka e gjallë që zbriti prej qiellit na bashkon në Meshën shenjte dhe na dhurohet si ushqim shpirtëror për jetën tonë dhe për jetën e botës. Aty ku mungon Buka, është e pranishme varfëria, trishtimi, hidhërimi, lodhja dhe pakënaqësia e vazhdueshme. Ndërmjetësia e Shën Nënë Terezës, bëftë që buka materiale që ushqen trupin dhe ajo shpirtërore që ushqen shpirtin, të mos

më keni ndihmuar mua” (krh. Mt 25, 31-46), të bëhen për Kishën dhe për institucionet shtetërore program jete dhe stil, me të cilin ju qasen varfërive të ndryshme dhe të shumta të shoqërisë sonë.

Lutja kushtuar Shën Nënë Terezës - kremtuesi:

Shën Nënë Tereza e Kalkutës, ti që të varfrit i vendose në qendër të preokupimit tënd, bëj që ne të pranishmit dhe të gjithë ata që e kanë dëgjuar fjalën e Krishtit, të mos jemi indiferent, kur një vëlla apo një motër e jona ka nevojë për ndihmën tonë! Nxirre hirin nga zemra e Jezusit, që vendet dhe njerëzit e pasur të kujdesohen për të varfrit dhe të jenë të barabartë në shpërndarjen e të mirave tua! Ndihtmona të kuptojmë se mëkati më i madh, që njeriu mund të bëjë është mungesa e dashurisë dhe moskujdesi për të afërmin! Amen.

Angazhimi personal – të gjithë së bashku me zë të lartë:

Meqenëse Jezusi na ka porositur, se dera nëpër të cilës kalohet në Parajsë është dashuria ndajë nevojtarëve, e pranoj angazhimin se do të mundohem ta mbajë të hapur gjithmonë këtë derë.

Angazhimi personal – të gjithë së bashku me zë të lartë:

I vetëdijshëm se edhe unë jam një Tempull i Zotit: e pranoj angazhimin se do të mundohem ta ruajë të pastër shpirtin tim.

Lutja e litanive të Shën Nënë Terezës, fq. 20.

Meshtari ngritët në këmbë, i drejtuar nga populli, ndanë bekimin përfundimtar të Meshës.

Kremtuesi: Zoti qoftë me ju!

Populli: Dhe me shpirtin tënd.

Kremtuesi: Ju bekoftë Hyji i gjithëpushtetshëm: Ati, Biri dhe Shpirti Shenjt!

Populli: Amen.

Kënga përmbyllëse kushtuar Nënë Terezës, fq. 23.

Dita e shtatë

Pas lutjes përfundimtare të Meshës vazhdohet me një këngë kishtare, ndërsa meshtari me ministrantat bien në gjuhë para altarit, ku do të jetë e vendosur edhe ikona e Nënë Terezës.

Kremtuesi: Ndhima jonë është në emër të Zotit!

Populli: I cili e krijoi qiellin dhe tokën.

Kremtuesi: O Zot dëgjoje lutjen time!

Populli: Dhe britma ime le të vijë te ti.

Hyrje e shkurtër nga ana e kremtuesit...

Lexuesi: Të meditojmë me Nënë Terezën!

A jam i bindur për dashurinë e Jezusit për mua dhe për dashurinë time për Të? Kjo bindje është porsi drita e diellit që bën të rritet limfa e jetës dhe bën të lulëzojnë gonxhet e shenjtërisë. Kjo bindje është shkëmbi mbi të cilin ndërtohet shenjtëria. Djalli mund të përdorë plagët e jetës, ai nganjëherë i përdor gabimet tona për të bërë, që të mendojmë se është e pamundur, që Jezusi të na dojë dhe se vërtet dëshiron të qëndrojë së bashku me ne. Ky është një rrezik për të gjithë ne. Kjo gjë është aq e trishtueshme, sepse është në kundërshtim të plotë me dëshirën e Jezusit, që pret për të thënë: Ai ju do gjithmonë, edhe kur nuk e ndjeni vetën të denjë. Jezusi të do me butësi, ti je i çmueshëm për të. Drejtoju Jezusit me besim të madh dhe lejoje të të dojë! E shkuara i përket mëshirës së Tij, e ardhmja provanisë së Tij, e sotmja dashurisë së Ij.

Moment heshtjeje

Vendosjen e luleve pranë ikonës së Nënë Terezës e përcjell një shpjegim i shkurtër:

Nënë Tereza – Gonxhe Bojaxhiu, si pak kush në historinë e njerëzimit, lulëzoi në mirësi, në dashuri dhe në dhurim të pafund.

Frytet e kësaj dashurie e mbështollën botën mbarë, përmes shërbimit të mijëra Motrave misionare dhe vullnetarëve të shumtë, që në shembullin e Gonxhes tonë vazhdojnë të lulëzojnë në shpalljen e Ungjillit të dashurisë. Ndërmjetësia e Shën Nënë Terezës bëftë, që jeta e secilit njeri të jetë një *gonxhe*, që lulëzon dhe jep aromë mirësie dhe dashurie!

Lutja kushtuar Shën Nënë Terezës - kremtuesi:

Shën Nënë Tereza e Kalkutës, ti që me jetën tënde na mësove se jeta është mundësi, bukuri, lumturi, sfidë, detyrë, pasuri, dashuri, premtim, pikëllim, himn, aventurë dhe kënaqësi: ndihmona, po të lutemi, që t'i kryejmë më përgjegjësi dhe dashuri detyrat e jetës! Na nxirr hirin nga zemra e Jezusi, që të dimë ta pranojmë, admirojmë, shijojmë, ballafaqojmë, kryejmë dhe ta këndojmë me besim dhe dashuri himnin e mrekullueshëm të jetës!

Angazhimi personal – të gjithë së bashku me zë të lartë:

Pasi që Ungjilli më mëson, se feja dëshmohet me vepra, e pranoj angazhimin, se do të mundohem të jem besimtarë i mirë, jo vetëm me fjalë, por edhe me veprime konkrete.

Lutja e litanive të Shën Nënë Terezës, fq. 20.

Meshtari ngritët në këmbë, i drejtuar nga populli, ndanë bekimin përfundimtar të Meshës.

Kremtuesi: Zoti qoftë me ju!

Populli: Dhe me shpirtin tënd.

Kremtuesi: Ju bekoftë Hyji i gjithëpushtetshëm: Ati, Biri dhe Shpirti Shenjt!

Populli: Amen.

Kënga përmbyllëse kushtuar Nënë Terezës, fq. 23.